

Në bazë të nenit 36 paragrafit (1) nënparagrafi 18 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.102/19) dhe neni 17 paragrafi (3) n.l paragrafi (1) nga Regullorja e punës të Këshillit Gjyqësor të RMV (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.274/19, 186/20 dhe 5/23), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 13.03.2023 solli si në vijim

**RREGULLORE
PËR MËNYRËN E FORMIMIT TE KOMISIONIT TË VERIFIKIMIT TË PLOTËSIMIT
TË KUSHTEVE DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË GJYKATËS
SI DHE MËNYRËN E PUNËS SË KOMISIONIT.**

Dispozita e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore parashihet mënyra e Formimit të Komisionit për verifikim të plotësisimit të kushteve dhe kriterëve për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, si dhe mënyra e punës së komisionit.

Formimi i Komisionit

Neni 2

Komisioni për verifikim të plotësisimit të kushteve dhe kriterëve për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Themelore, Gjykatës Apelit, Gjykatës Administrative, Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm:Komisioni), formohet në të njëjtën seancë, në të cilën Këshilli sjellë vendim për Publikim e Shpalljes për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës.

Neni 3

Komisioni është i përbërë prej tre anëtarëve nga radhat e anëtarëve të Këshillit, me të drejtë vote, të zgjedhur në mënyrë të shortit, me të cilën dy anëtarë janë të zgjedhur nga radha e gjykatësve, ndërsa një anëtar i zgjedhur nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa mes tyre me short zgjidhet kryetari i Komisionit.

Mënyra e punës

Neni 4

Komisioni nga neni (2) të kësaj Rregullore:

- e kontrollon afatin dhe kompletimin e dokumenteve të kandidatëve;

- kontrollon funksionimin e e-mail adresave të kandidatit;
- shqyrton dhe vlerëson programin e punës me planin e veprimit
- grumbullon notën për punën e kandidatëve;
- realizon testin psikologjik dhe testin për integritet të kandidatëve;
- organizonë vlersimin e punës praktike me kompjuter;
- realizon intervistë me kandidatët,
- përgadit Raport me Propozim Listën e kandidatëve të cilën e dërguan deri te Këshilli.

Kontrollimi afatit dhe kompetimi dokumenteve

Neni 5

(1)Komisioni në mbledhje diskuton për afatet kohore të aplikimeve dhe plotësimin e dokumenteve të kandidatëve për shpalljen për zgjedhje të kryetarit të gjykatës.

(2)Komisioni përgadit procesverbal, ndërsa në bazë të procesverbalit përgadit Raport që e dërgon në shqyrtim dhe miratim në seancë të Këshillit.

(3)Aplikimet jo nëkohë dhe jo tëkompletuar në Shpallje, Këshilli do t'i refuzojë ato, për të cilën do ti njoftojë kandidatët përmes e-maill adresës elektronike.

Kontrollimi e-maill adresë

Neni 6

Komisioni kontrollon funksionimin e adresës së e-maill të kandidatit për të parë nëse kandidati është gati të përgjigjet deri ditën tjetër të punës. Nëse kjo është e pasuksesshme, kandidati mund të ofrojë një mundësi tjetër të komunikimit.

Programi për punën me planin e veprimit

Neni 7

(1) Në programin e punës gjatë mandatit, kandidati paraqet pikëpamjen e tij për programet në funksionimin e gjykatës, mënyra e zgjidhjes dhe promovimit të gjykatës me plan veprim për zbatimin e programit gjatë katër viteve.

(2)Komisioni shqyrton dhe vlerëson programin e punës të Plan veprimit të kandidatëve.

Vlerësimi i punës

Neni 8

Merr notën që ka marrë kandidati nga vlerësimi i rregullt ose i jashtëzakonshëm kandidati.

Testi psikologjik dhe testi për Integritet

Neni 9

(1) Sipas kërkesave ligjore, kandidati posedon integritet dhe aftësi sociale për të kryer funksionin gjyqësor, për të cilën realizohet testi për integritet dhe testi psikologjik, Komisioni kryen testimin e kandidatëve që nuk kanë kaluar testin psikologjik dhe testin e integritetit, ose deri në ditën e Publikimit të shpalljes për përzgjedhje kanë kaluar katër vjet nga dita e dhënies së mendimit profesional. (2) Komisioni do t'i informojë personalisht për ditën dhe orën e realizimit të testit psikologjik dhe testit të integritetit.

Kontrollimi punës praktike me kompjuter

Neni 10

(1) Për kandidatët të cilët janë zgjedhur për gjykatës nga data 26.11.2010 kur hyri në fuqi Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.150/10) me të cilën është instaluar vërtetimi i njohurive praktike të punës me kompjuter, komisioni nuk organizon vërtetimin e njohurive me kompjuter.

(2) Për Kandidatët të cilët janë zgjedhur për gjykatës pas datës 26.11.2010 realyohet bëhet vërtetimi i njohurive të punës praktike me kompjuter nga ana e Komisionit për vërtetimin e njohurive të punës praktike me kompjuter të formuar nga Këshillit Gjyqësor, ndërsa për datën ,orën dhe për vërtetimin e njohurit të kandidatëve i njofton Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni.

(3) Kandidatët për të cilët Këshilli ka kryer kontrollimin e vërtetimit të njohurive praktike me kompjuter, nuk do të zbatohet përsëri vërtetimi i njohurive.

Intervist

Neni 11

Komisioni përcakton ditën, orën dhe vendin për mbajtjen e intervistës me kandidatët të cilën e publikonë në Veb Faqen e Këshillit dhe personalisht i njofton kandidatët në afat prej 5 ditë, para ditës së mbajtjes së intervistës.

Raport dhe propozim listë të kandidatëve

Neni 12

(1) Komisioni përpilon Raport të përgjithshëm të procedurës në të cilën vendosë të dhënat për numrin e përgjithshëm të kandidatëve të paraqitur në shpallje, rezultatet e testit për integritet dhe testit psikologjik dhe të kontrollit të punës praktike me kompjuter, vlerësim të kandidatit, vlerësimi i programit të punës së kandidatit dhe intervista e realizuan me kandidatët.

(2) Pjesa përbërse e Raportit është Propozim lista e kandidatëve e përbërë në bazëz të alfabetit rëndor nga mbiemrat e kandidatëve, në të cilën përmbanë:

- Emrin dhe Mbiemrin e kandidatit;
- Gjykata në të cilën e kryen funksionin;
- Të dhënat e përgjithëshme të stazhit të kandidatit dhe

-Nota për punën.

(3) Rapotin me propozim listen e kandidatëve, Komisioni e dërgon te Këshilli.

(4) Gjatë përpilimit të Propozim listës të kandidatëve, Komisioni do të respektoj përfaqësimin e drejtë dhe adekuat në zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave.

Dispozita përfundimtare

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e sjelljes, dhe publikohet ne Ueb faqen e Këshillit Gjyqësor.

Nr.01-584/1
13 mars 2023
Shkup

KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Kryetar,

Vesna Dameva